

## Kongresi i VI-të i jashtëzakonshëm zgjedhor i BSPK-së



**Prishtinë 2 dhjetor 2011** -Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, BSPK më 2 dhjetor 2011, mbajti Kongresin e VI-të jashtëzakonshëm zgjedhor në Gjakovë. Në Kongres morën pjesë 8 degë:

1. Shëndetësia – FSSHK;
2. Ferronikeli – SPMK;
3. Agrokompleksi – SPAGK;
4. Ndërtimtaria – SPNPK;
5. Judikatura – SPJK;
6. Minatorët – SP Minatorët e Trepçës;
7. Burgjet – Gardianët – SPHKK;
8. Rrjeti i Gruas.

Prezent në punimet e Kongresit ishin edhe degët e SP të Doganave të Kosovës, Pylttarisë, Tekstilit dhe SP të Pensionistëve të Kosovës në cilësinë e vëzhguesit. Të pranishëm në Kongres ishin edhe përfaqësuesit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), kryetari i BSPSH-së me delegacion nga Shqipëria.

Në Kongres u lexua telegram mbështetës nga ITUC ( Sindikatat botërore) të cilat rikonfirmuan mbështetjen për BSPK-në dhe kryetarin Arifi e nënshkruar nga Sharon Burov sekretare gjenerale e ITUC-ut. Nga gjithsej 68 delegatë nga 8 degët e lartë përmendura të pranishëm në Kongres ishin 61 delegatë me të drejtë vote të cilët unanimisht rizgjodhën Haxhi Arifin për kryetar të BSPK-së.

Kongresi i VI –të zgjedhor gjithashtu miratoi Raportin e Punës, Raportin Financiar u miratua edhe Draft Statuti i BSPK-së me propozime dhe sugjerime për Komisionin Statutar të BSPK-së, u bë harmonizimi i Statutit të BSPK-së me atë të ITUC-it te pika e mandatit të kryetarit dhe u aprovua nga 4 në 5 vite.

Për të pasur emërtimin Degë – Federatë, delegatët e Kongresit bënë ndryshim te numri i anëtarëve nga 1000 që ka qenë deri tani në statut në 500 anëtarë, gjithashtu u miratuan edhe 3 Rezoluta, të cilat kanë të bëjnë me organizimin dhe veprimtarinë e BSPK-së në mandatin e ardhshëm. Punimet e Kongresit u zhvilluan në atmosferë të qetë dhe festive. Ndërsa tubimi i dy degëve në Prishtinë i ashtuquajtur “Kongresi i mbajtur në Prishtinë”, është jo legjitim dhe nuk ka përkrahje nga sindikatat ndërkombëtare ku BSPK-ja është anëtare. \*\*\*